

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E NDIKIMIT NE MJEDIS

(Raporti i hartuar ne baze te shtojca II dhe VKM Nr. 686, date 29.07.2015, per VNM)

Objekti:

Klasifikimi i projektit: Në bazë të Ligjit nr.52/2020 te date 30.04.2020 per disa ndryshime te ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, ky aktivitet perfshihet ne Shtojca I, Menaxhimi Mbetjeve pika ID. 5.5. Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme dhe ID. 5.8. Magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave

Adresa: Me vendndodhje në Dobresh, Njesia Administrative Berzhite, Bashkia Tirane.

Zhvillues Shoqëria: “SBFD FRIGO 09” Shpk

Raporti u perpilua nga:

“Studio 2B Consulting”

Pregatiti:

Bledar Bali

Tirane 2022

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Permbajtja

Hyrje

- I. Informacion për qëllimin e vleresimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe metodikën e zbatuar
- II. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti
- III. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj.
- IV. Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;
- V. Përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasishtë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- VI. Informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- VII. Informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- VIII. Informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- IX. Informacion mbi shkarkimet në mjedis nga aktiviteti
- X. Programi i permiresimit të procesit të punës dhe masat zbutese
- XI. Programi i vetmonitorimit dhe menaxhimit

Hyrje

Një mjedis i paprekur është një bazë esenciale për jetën e përditshme dhe, për pasojë, shëndetin, mirëqenien, ekonominë dhe konkurrencën e Shqipërisë. Shërbejnë marrja e masave për të mbrojtur burimet natyrore dhe për t'i përdorur ato në mënyrë të qëndrueshme, për të mbrojtur ekosistemet e qëndrueshme dhe për të ruajtur një shkallë të lartë të diversitetit biologjik dhe peizazhor, si dhe për të mbrojtur klimën dhe për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike në fund të fundit. Këto gjithashtu përfshijnë ujë të pastër dhe ajër, pjellorinë e tokës, pllenim, mbrojtje kundër rreziqeve natyrore dhe një furnizim ade-quate të energjisë dhe lëndëve të para.

Qellimi i projektit do të jete per zhvillimin e nje aktvitetit “MAGAZINIM I HEKURISHTEVE/SKRAPEVE TË METALIT QË NUK PËRMBAJNË MATERIALE TË RREZIKSHM OSE ÇMONTIM I MBETJEVE NGA MOTORËT E MAKINAVE”, me vendndodhje në Dobresh, Njesia Administrative Berzhite, Bashkia Tirane. Ky investim do te kryhet ne prone shoqerise “SBFD FRIGO 09” Shpk, në pasurinë me 426/81, zona kadastrale nr.1498.

Klasifikimi i projektit: Në bazë të Ligjit nr.52/2020 te date 30.04.2020 per disa ndryshime te ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, ky aktivitet perfshihet ne Shtojca I, **Menaxhimi Mbetjeve pika ID. 5.5. Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme dhe ID. 5.8. Magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave.**

Per ndertimin e struktures dhe permbajtjes se raportit paraprak te VNM-se bazohemi ne vendimin nr.686 date 29.07.2015 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore”, i ndryshuar kreu II.

Specifikime teknike te veprimtarise:

Objekti: “MAGAZINIM I HEKURISHTEVE/SKRAPEVE TË METALIT QË NUK PËRMBAJNË MATERIALE TË RREZIKSHM OSE ÇMONTIM I MBETJEVE NGA MOTORËT E MAKINAVE”,

Vendndodhja: Me vendndodhje në Dobresh, Njesia Administrative Berzhite, Bashkia Tirane

Zhvillues Shoqëria: “SBFD FRIGO 09” Shpk

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE




Fig.1. Planvendosja e objekti


Siperfaqja ku do të mblidhen metalet do të jetë e hidroizoluar, shtruar me beton të cilësise se larte që do të mund të ndalimin e shkarkimeve të lengshme në shtresat e nëntokës. E gjithë sipërfaqja e objektit do të jetë e rrethuar pjesërisht me mur, si dhe gjelberim në mënyrë që mos të ketë pamje vizuale nga rruga ose të ketë hyrje në kantier të personave të paautorizuar. Gjithashtu do të ketë një kampion ku do të vendosen mallrat e ndryshme etj. Stoku i skrapit do të ndahet në kampanat e vecanta, sipas llojit të materialit.

Grumbullimi, seleksionimi, magazinimi i skrapëve të metalit do të kryhet sipas VKM-së nr.660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve”. Magazinimi i hekurishteve/skrapëve të metalit dhe stacioni i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme. Materialet do të grumbullohen dhe do të shkarkohen në sheshin e dedikuar për materialet skrap jo të rrezikshme.

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE



Fig.2. Ortofoto e prones



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE



Fig.3. Paraqitja e sheshit te ndertimit ne harten topografike

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Nr.	Koordinatat Lindje X	Koordinatat Veri Y
Pika 1	4407050.088	4570326.793
Pika 2	4407019.632	4570296.338
Pika 3	4406951.086	4570362.939
Pika 4	4406995.527	4570391.832

Tabela me pikat orientuese me koordinatat Gauss – Kruger

Nr.	Koordinatat Lindje X	Koordinatat Veri Y
Pika 1	490715.027	4569607.192
Pika 2	490686.327	4569579.192
Pika 3	490617.727	4569635.192
Pika 4	490665.327	4569668.792

Tabela me pikat orientuese me koordinatat KRGJSH

Nr.	Emertimi i treguesve	Njesia e Matjes	Sasia
1	<i>Sipërfaqja e zonës së propozuar për zhvillim</i>	<i>m²</i>	<i>4000</i>
2	<i>Sipërfaqja e zënë nga struktura</i>	<i>m²</i>	<i>800</i>
3	<i>Zona Kadastrale</i>	<i>nr</i>	<i>1498</i>

I. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Raporti paraprake i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin disa procese:

- a) Procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) Procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit.
- Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit te propozuar;
- Mundeson informimin e vendim-marresve, duke gjykuar ne miratimin ose jo te projektit dhe kushteve qe duhet te vendosen ne aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimit e pakthyeshme te mjedisit;
- Ndikon ne mbrojtjene burimeve natyrore, paisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit
- Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit.

Baza ligjore

Legjislacioni mjedisor është ndertuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit.

Kështu, ndër me kryesoret mund të përmendim.

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Nr. 10 440, datë 07.07.2011	"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
Nr. 10 463, date 22.09.2011	"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"
Nr.156. date 10.10.2013	"Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 10463 dt, 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"
Nr.10 448, datë 14.07.2011	"Për lejet e mjedisit"
Nr.9108 date 17.07.2003	"Substancat dhe preparatet kimike"
Nr.9115 datë 24.07.2003	"Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
Nr.8897 datë 16.05.2002	"Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
Nr.9587, datë 20.07.2006	"Për mbrojtjen e biodiversitetit"
Nr.8906, datë 6.6.2002	"Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008"
Nr.10 081, datë 23.02.2009	"Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
Nr.10006, date 23.10.2008	"Per mbrojtjen e Faunes se eger"
Nr.9587, datë 20.07.2006	"Per mbrojtjen e biodiversitetit"
Nr.7875, datë 23.11.1994	"Per mbrojtjen e faunes se eger dhe gjuetine", i ndryshuar me: Ligjin Nr. 9219 date 08.04.2004"
Nr.9385, datë 04.05.2005	"Per pyjet dhe sherbimin pyjor i ndryshuar me: - Ligjin Nr. 9791 date 23.07.2007"
Nr. 8770 dt 19.04.2001	"Per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike, i azhurnuar"
Nr. 9774 datë 12.07.2007	"Për administrimin e zhurmes"

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Nr.8402 datë 10.9.1998	"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit i ndryshuar me: - Ligjin Nr.9826, datë 1.11.2007"
Nr. 9385, datë 4.5.2005	"Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
Nr. 8766, date 05.04.2001	"Per Mbrojtjen nga zjarri dhe per shpetimin"
Nr. 8756, datë 26.03.2001	"Për emergjencat civile"
Nr. 8652, date 31.07.2000	"Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"

Udhezime dhe Rregullore

Nr.6527, datë 24.12.2004	"Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre"
Nr.5, datë 28.12.2007	"Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore"
Nr. 6, datë 27.11.2007	"Miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta"
Nr. 6527 dt 24.12.2004	"Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis gazet dhe zhurmat I ndryshuar me: - Udhëzimin Nr.12, datë 15.6.2010"

Ne baze te ligjit nr.10431 dt 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", neni 3 i tij, citojme objektivat e mbrojtjes se mjedisit.

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;

f. Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

Studimi dhe vlerësimi i efekteve mjedisore është një moment i rëndësishëm e ciklit të zhvillimit të një projekti. Studimi mund të kryhet njëkohësisht ose paralelisht me procesin e planifikimit të projektit dhe prezantohet si me vete ose si pjesë e studimit të përbashkët. Hartimi dhe zhvillimi i një projekti të qëndrueshëm lidhet me kompleksitetin e projektit, menjanimin e streseve mjedisore të mundshme, ndjeshmerinë e komponenteve mjedisore të zonës ku do të zbatohet dhe masat që do të ndermerren për mbrojtjen e mjedisit. Vëmendje të vecante do të kushtohet projekteve që shkaktojnë efekte mjedisore negative të dukshme siç mund të jenë ndertimi i impianteve industriale që shoqërohen me emetime, veprat e infrastruktures (rruge të reja) që shoqërohen me efekte që është shumë e vështirë të identifikohen, efekte që vijnë si rezultat i rritjes së aksesit ndaj burimeve si dhe projekte që intereferojnë me ekuilibrin natyror të natyrës. Në rastet e implementimeve të projekteve të ndryshme me impakte në mjedis, aspektet me të rëndësishme mjedisore që duhen konsideruar në zonën ku do të zhvillohet projekti janë:

- Situata aktuale mjedisore dhe evidentimi i ekosistemeve specifike;
- Problemet ekzistuese mjedisore dhe gjendja e ekosistemeve të ndryshme në rast se projekti nuk zbatohet;
- Përshkrimi i efekteve mjedisore të shkaktuara nga projekti dhe alternativat;
- Vlerësimi i stresit të përgjithshëm mjedisor në të ardhmen;
- Nderveprimi i efekteve ekologjike, ekonomike, sociale dhe kulturore;
- Rekomandime për alternativa me efekte negative me të ulëta (metoda alternative, kufizimi i emetimeve, ndotjes në përgjithësi);
- Vlerësim të përgjithshëm të situatës mjedisore në prespektivën e zhvillimit dhe funksionimit të projektit;

Për të bërë studimin për zonën mjedisore duhet të bazohemi tek dokumentacioni dhe studimet ekzistuese. Duke stimuluar vendosjen e projektit në një zonë të caktuar përcaktohen edhe efektet si bashkëveprimi i veçorive të projektit dhe mjedisit që prekin ciklet natyrore dhe shkaktojnë efekte dytësore social-ekonomike mbi popullatën e rajonit.

Parimet e hartimit të VNM-es *Parimet e mbështetura në Kreun II të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";*

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i kujdesit
- Parimi i parandalimit
- Parimi "ndotësi paguan"

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

- Parimi i riparimit te dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit te mjedisit te dëmtuar
- Parimi i përgjegjësisë ligjore
- Parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte
- Parimi i integritit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale
- Parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore
- Parimi i transparencës ne vendimmarrjen mjedisor

II. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI

Pozita gjeografike e Tiranës

Qyteti i Tiranës është qyteti më i madh i Shqipërisë dhe qendra më e madhe ekonomike, administrative, politike, industriale, akademike, sociale dhe kulturore e vendit. Tirana ndodhet vetëm 17 km larg aeroportit "Nënë Tereza", i vetmi aeroport ndërkombëtar në Shqipëri i njohur dhe me emrin Rinas dhe rreth 35 km në lindje të Durrësit.



Ortofoto ku ndodhet objekti

Ne momentin e hartimit të raportit të vlerësimit mjedisore nuk u vrehen bimesi e vecante, aktualisht prona është e zënë nga objekti dhe pjesa tjetër është e sistemuar. Përqark kësaj zone ku është planifikuar të kryhet ky aktivitet nuk preken objekte të tjera. Për këtë projekt nuk kemi vlerësim të sipërfaqes bimore pasi objekti që do të ndërtohet nuk prek bimesi, nuk prek sipërfaqe pyjore dhe kullësore. Në përshkrimin topografik kemi të bëjmë me një sipërfaqe të sheshtë.

Prona në studim ndodhet në rrugën Mehmet Beka, Njesia Administrative Berzhite, Bashkia Tiranë. Pozicioni i pronës është mjaft favorizues për ndërtimin e objekteve të shërbimit për shkak se kjo zonë është larg intensitetit të lartë zhurmave të qytetit të Tiranës.

Pozicioni i pronës është mjaft i mirë dhe i përshtatshëm për zhvillimin e këtyre aktivitetit pasi është larg nga qendrat e banuara.

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE



Foto te sheshit te marre ne vleresim

Ne kete rajon te Tiranes gjenden rreth 1600 lloje dhe varietesh bimesh te larta duke u nisur nga kriptogramat vaskulare. Kjo shifer eshte mjaft e lart po te merret ne konsiderate dhe sipërfaqet e tokes se botanizuar, numri relativisht i madh i llojeve qe gjenden ne rrethinat e Tiranes, eshte i lidhur ngushte me relievin e ndryshueshem me lartesi 550-600 m (mbi nivelin e detit). Kjo ben qe klima dhe bimesia te ndryshoje nga nje vend ne nje tjetër. Zona ben pjese ne brezin e shkurreve dhe drureve mesdhetare (lartesia mbi nivelin e detit eshte nga 100-200 m ku permendim pyjet halore, gjethegjere te cilat si rezultat i urbanizimit te zones u prene dhe jane zevendesuar me peme frutore dhe dekorative. Si shkurre mesdhetare me gjethe gjithnje te gjelberta mund te permendim llojet Qurces Hex, Pistaccia Lentiscus, Arbutus Unedo, etj. Ne kete zone vazhdojne te mbijetojne ne pakice si: makiet, shiblaku, driza (paliurus spina-christi), cermedelli (cotunus coggygria), shqemia (rhus coriaria), murrizet, thanat, etj. Ne kete zone mbizoterojne vreshtat, ullishtet dhe pemet frutore si hurma, shege, portokall, limon, sidomos karakterizohen per mbjellje te fiquve qe i japin mjedisit nje pamje te bukur ne vere, dhe gjithashtu dallohen barera dhe fieri shqipja (pteridium aquilinum). Zona e makieve ne pjesen jugore te Tiranes vjen e ngrihet deri ne lartesine 400 m (mbi nivelin e detit). Fizionomia floristike e kesaj zone percaktohet prej shkurreve me gjethe gjithnje te gjelberta dhe te tilla qe i leshojne ato ne periudhen e dimrit. Ne te njejten zone rriten dhe drure submesdhetar. Ne kete zone rriten dhe nje mori specie bimesh medikale.

Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarit e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mire menaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre. Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar nje ligj mbi te cilin të mbështetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë

u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke u shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” (Kategoria II)

Ndodhet në Qarkun e Tiranës dhe në rrethin e Tiranës. Sipërfaqja aktuale 29,384,18 ha. Zonë me vlera peizazhore, kulturore dhe historike e tradicionale. Në këtë park shprehen mjaft mirë zonat fitogjeografike: makja mesdhetare, dushkajat (Quercetum), ahishtet (Fagetum) dhe kullotat subalpine e alpine. Takohen dhe drurë të rrallë e të mbrojtur të gështënjes dhe arrës. Ndër gjitarët veçojmë praninë e ujkut (Canis lupus), ariut (Ursus arctos), derrit të egër (Sus scrofa), kunadhës (Martes foina) dhe maces së egër (Felis sylvestris). Vlerave të saj shkencore dhe didaktike u shtohen dhe ato peizazhore, shlodhëse, argëtuese dhe historike e kulturore, që përbëjnë dhe potenciale për zhvillimin e turizmit. Në park përfshihen formacione të ndryshme gjeologjike dhe liqeni i Bovillës. Ka plan menaxhimi.

Kufijtë e dixhitalizuar përfshijnë:

- a) Në Veri: Kufiri ndërmjet rrethit të Krujës dhe të Tiranës, Maja e Fraveshit (794 m)- (4403610.75L/4595619.92V).
- b) Në Lindje: Maja Henzit (1807.0 m) - (4411214.23L/4598279.97V).
- c) Në Jug: Kuota 542.0 m (4421481.54L/4576965.76V), ndjek rrjedhën e lumit Erzen.
- d) Në Perëndim: Grykën e Skoranës deri te kuota 444.0 m (4412192.02L/4569269.69V), vijon me kuotat 890.0 m (Maja e Kuorës).

Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke u shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona në vlerësim nuk vlerësohet si zone me status të veçantë nga Ministria e Mjedisit. Sic shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim përmban zonat e mbrojtura si mëposhte:

Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyre

Zona ne fjale nuk ben pjese ne asnje kategori te zonave te mbrojtura dhe nuk mbart vlera kulturore dhe historike per vendin.

Flora

Lista e llojeve te rrezikuara te bimeve ne nivel kombetar eshte shume e madhe, gjithsej 319 lloje, nga te cilat jane te rrezikuara ne forme kritike 76 lloje, konsiderohen ne rrezik 123 lloje dhe te perkeqesuara 120 lloje, te cilat perballen me nje rrezik te larte ne kontekstin kombetar. Kercenimet kryesore ndaj biodiversitetit jane: zhvillimi industrial, urbanizimi, gjuetia ilegale, peshkimi, erozioni i tokes, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, sektore keto qe kane ndikim ne shumellojshmerine biologjike. Aktivitetet antropogjene ku shpyllezimi dhe shkretetirezimi i tokes se punueshme, aq sa shkaterrimi i livadheve dhe kullotave, kane pasur nje ndikim te madh ne ndryshimet e habitateve ne te kaluaren e afert. Ndertimi i rrugëve dhe ndryshimet ne rrjedhen e ujit ose ndertimi i digave, ndertimi i tubacioneve, ndotja qe vjen nga origjina te ndryshme, zjarret, semundjet dhe ndryshimet klimatike jane arsyt e degradimit dhe fragmentimit te habitateve ne Shqiperi. Mbrojtja e biodiversitetit mund te arrihet vetem duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes se zhvillimit te qendrushem ne sektore qe lidhen me biodiversitetin, te tilla si bujqesia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi. Shqiperia njihet per nje diversitet te larte te ekosistemeve. Brenda territorit te saj ka ekosisteme detare, bregdetare, liqenore, lumore, shkurre me gjelberim te perhershem dhe gjethegjere, pyje gjethegjere, pyjet me pisha, kullotat dhe livadhet alpine dhe sub-alpine, dhe ekosistemet e larta malore.

Fauna

Sipas perditesimeve me Nentor 2013 te Unionit Nderkombetar per Ruajtjen e Natyres (IUCN), 109 lloje kafshesh te grupeve te ndryshme taksonomike jane konsideruar si te kercenuara, por persa i perket faunes, zona e projektit paraqet specie tipike te zonave rurale. Rriqebulli, macet e egra, dhe nuselalat jane te rralla, por mbijetojne ne disa pjese te vendit. Ka rreth 760 lloje te kurrizoreve te gjetura deri tani ne Shqiperi. Nder keto ka mbi 350 specie zogjsh, 330 peshq te ujerave te embla dhe detare dhe 80 lloje gjitaresh. Disa prej llojeve me te rendesishme te shpendeve qe gjenden ne vend perfshijne shqiponjen e arte - te njohur si simbol kombetar te Shqiperise - specie te hutave, Capercaillie dhe shpend uji te shumte. Ekosistemet bregore paraqesin nje biodiversitet me interesant pasi ata paraqesin bimesi bregore natyrore dhe keshtu terheqin faunen qe lidhet me ekosistemet bregore.

Trashëgimia kulturore

Brenda Bashkise se Tiranes perfshihen 14 monumente natyrore qe jane zona te mbrojtura (kategoria III) dhe ne te cilet zbatohet shkalla e pare e ruajtjes. Qyteti ka shumë objekte të trashëgimisë kulturore, peizazhe kulturore dhe historike. Prandaj zhvillimet e paplanifikuara do

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

të kenë një efekt negativ në trashëgiminë kulturore. Parashikohet ristrukturime të vlerave, por pa shkaktuar rritje të konsumit të tokës. Rigjenerimin e rrugicave. Zgjerimin e rrugëve dhe aktiviteteve artistike në rrugë për të rritur gjallërinë urbane.

Monumentet Natyrore te Rrethit Tirane. (Sipas VKM 676)

Bokerimat e Mustafa Koçajt	Gryka e Murdarit
Shpella e Shutresë	Shkalla e Tujanit
Shpella e Zezë (Pëllumbasit)	Bokerimat e Mnerit
Shpella e Valit	Rrapi i Priskës
Tarraca detare e Dajtit	Rrapi i Kranës – Dajt
Karsti i Malit me Gropa	Rrapi i Ndroqit
Gryka e Skoranës	Arra e Babë Myslymit

Tirana njihet si vend banim i hershem dhe objektet monumetale te ketij rajoni jane te shumta. Ne tabelen e meposhtme po listojme disa te tilla sepse ne rang qarku jane 153 cope te tilla.

RRETHI I TIRANËS									
NR.	EMRI I MONUMENTIT	FSHATI	KOMUNA	BASHKIA	RRETHI	KATEG.	INSTITUCIONI I SHPALLJES	NR. VENDIMI	DATA SHPALLJES
1	KALAJA NE QYTETIN E TIRANES			TIRANE	TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
2	KALAJA E DORZES ne fshatin Peze e Madhe	PEZE E MADHE	PEZE		TIRANE	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
3	KALAJA E VAROSHIT ne bregun e majte te Drenës, ne kullen 377, ne fshatin DROG, muret e kalases me 10 metra distanca meqenë sive	NDROG	NDROG		TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
4	KALAJA ne fshatin Labri	VAGARR	VAGARR		TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
5	KALAJA E PETRELES ne Jug Lindje te Tiranes, ne kullen 352, duke perfaqshur gjithe kalasen me muret e saj si dhe muret e poshtme qe flisqin nga porta deri afer shtetes.	PETRELE	PETRELE		TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
6	KALAJA E TUJANIT ne fshatin Shtati Tujan	Tujan	DAJT		TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
7	KALAJA E PREZES ne fshatin Peze, ne kullen 136, muret e kalases duke perfaqshur kalasin, porten e dhe gerdaninat perrethas	PREZE	PREZE		TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
8	KALAJA E DAJTIT ne rreze te malit Dajt	Dajt			TIRANE	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
9	SHPELLA E PELLUMBASIT	PËLLUMBAS	BËRZHITË		TIRANE	I	M.K.R.S.(Drejt. e Trasheg. Kulturore	Nr. prot. 3967	10.10.2002
10	MURET ANTIKE DHE VARRI I PESHKQORIT ne malin e Petroleles, mbi laperin e malit ne kulle 592, me rreze distanca prej 10 metra larg mures.	PETRELE	PETRELE		TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
11	URA E TABAKEVE ne film te muges "As Demir", 25 metra e gjate.			TIRANE	TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
12	URA E BRARIT, 10 m ne Ver-Lindje te Tiranes, mbi kullen e Tiranes, 10 metra e gjate	BRAR	DAJT		TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
13	URA KANAL ne fshatin ZALLHERR	ZALLHERR	ZALLHER		TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës		Urdhëres 08.01.1977
14	KULLA E SAHATIT ne qendren e qytetit, godina me distanca 5 metra meqenë perfaqsh.			TIRANE	TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
15	PURIT ME KUPOLË E NE QENDER TE QYTETIT PREZE	PREZE			TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2509/1	30.06.1963
16	RRENDOJAT E KISHES SHEN MARISE	LINZE- Shermi	DAJT		TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	687	30.05.1970
17	KHAMIA E ETHEM BEUT ne qender te qytetit, godina e rrethuar ne 4 anet me mure, duke perfaqshur edhe dy varret			TIRANE	TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
18	TYRBJA E KAPLAN PASHES, ne kenden e kryesimit "25 nentor" me rruget "Majno Shyti", godina me rreze periferi prej 5 metra meqenë perfaqsh.			TIRANE	TIRANE	I	Aprov. Ligj. Nr. 609, dt. 24.05.1948	586 4874	17.03.1948 23.09.1971
19	TYRBJA E NUSE'S ne fshatin Muzet	MULLET - PETRELE	PETRELE		TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës		Urdhëres 08.01.1977
20	TEGEJA E SHEN DYRRIT			TIRANE	TIRANE	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
21	MOZAIKU NE BLOKUN PARTIZANIT ne qytetin e Tiranes.			TIRANE	TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1886	10.06.1973
22	GODINA IRI BIBLIOTEKA KOMITETARE Pr. Adm. Kodr. Nr. 7, lagja 28 nentor.			TIRANE	TIRANE	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
23	BANESA E ISH TOPTANAVE (fshati Shtati, lagja "29 nentor", Rv. Myslym Shyti, Nr. 11.			TIRANE	TIRANE	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
24	BANESA E HYSEH KAZANIT, Pr. Fadi Rada, Nr. 22, ne qytetin e Tiranes.			TIRANE	TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1883	10.06.1973
25	BANESA E RESHAT PETRELES, ne rruget e "Barrakadaver", Nr. 109, ne qytetin e Tiranes.			TIRANE	TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2854 814	08.08.1960 25.10.1980
26	BANESA E SHIRAKASVE, Rruge "Indri Luata", Nr. 14, ne qytetin e Tiranes.			TIRANE	TIRANE	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	1883	10.06.1973

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

Pershkrimi i Klimes

Klima

Zona per te cilin flasim perfshihet ne zonen klimatike mesdhetare fushore te Shqiperise. Klima e kesaj zone karakterizohet nga dimra te bute e te laget dhe vera te nxehta e te thata.

Diellezimi

Rajoni merr sasi te medha oresh diell. Vlera e zgjatjes vjetore te djellezimit leviz ne kufijte 2600- 2700 ore. Edhe numri i diteve me diell leviz nga 320-330 dite. Vlerat me te larta jane vrojtuar ne korrik, 373 ore me diell, dhe me te ultat ne dhjetor 118 ore. Edhe radiacioni diellor ndjek pothuaj te njejten shperndarje vjetore si dhe diellezimi. Energjia diellore mesatare gjate nje viti eshte 1600 kW ore/m², vlerat me te larta jane vrojtuar ne Korrik 223.5 kW ore/m² dhe me te ultat ne Dhjetor 52.9 kW ore/m², ne tabelen e meposhtme jane dhene mesataret shume- vjecare mujore te shperndarjes se diellezimit si dhe radiacioni diellor i pergjithshem.

Tabela: Diellezimi (ore) dhe radiacioni diellor (kW h.m2)

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetor e
Tirana	6.5	5.8	5.2	4.6	5.5	8.1	17.3	17.6	13.5	9.6	6.1	6.1	105.9

Tabela: Vlera mesatare e diteve me re

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	12.3	12.6	12.2	11.7	7.2	4.3	1.2	1.8	3.6	7.2	11.9	12.7	98.7

III. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ

Nuk ndodhet ne brendesi te burimeve ujore te rendesishme si Lumenjte kryesore, Liqene, Rezervuar apo Zona Bregdetare. Ne zonen ku eshte parashikuar te zhvillohet prona burimi ujore me i afert ne sipërfaqen ne vleresim jane Lumi Erzen me distance rreth 400 m. Ky burim ujore nuk kane ndikime ne objektin qe zhvillohet. Parku kombetare i Dajtit eshte ne lindje nuk ka ndikim nga objekti.



Pozicioni i Objektit ne lidhje me burimet ujore



Foto nga Lumi Erzen

Monitorimi i cilesise se ujit ne lumenjte kryesore te Shqiperise kryhet nga disa institucione shkencore, ne vartesi te MM, MSH, Akademise se Shkencave. Cilesia e ujit te pishem, perfshire aspektin bakterologjik monitorohet nga Ministria e Shendetesise, permes Drejtorive te Shendetit Publik ne Rrethe.

Ndotja e burimeve ujore dhe mjedisit detar është problem serioz, kryesisht, për shkak të grumbullimit dhe trajtimit të pamjaftueshëm të ujërave të ndotura, rrjedhjeve në kanalet e ujërave të zeza dhe vendeve të grumbullimit të mbetjeve. Kanalizimet e ujërave të zeza përbëjnë një problem të përhershëm në vend, ku rreth gjysma e popullsisë urbane është e lidhur me rrjetet e ujërave të zeza.

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktareve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara.

Kryesisht janë minitoruar vetite fiziko-kimike të ujërave të lumenjeve, liqeneve dhe zonat bregdetare në derdhje të kolektoreve në dete, në: 37 stacione në lumenjte kryesore te vendit Drin, Bune, Mat, Ishem, Erzen, Seman, Shkumbin dhe Vjose ku stacion i ri per vitin 2018 eshte pika e monitorimit ne Devoll; 3 stacione per tributaret e liqenit te Ohrit; 10 stacione ne liqenet natyrale, Oher, Shkoder, Prespe, Prespe e Vogel (stacion i ri), dhe laguna e Butrintit; 14 stacione ne ujerat e zones bregdetare ne qytetet Durres, Vlore, Sarande, Shengjin (2 stacione te reja monitorimi) dhe Velipoje (2 stacione te reja monitorimi).

Vleresimet per vitin 2018 e cilesise se ujrave te:

-Basenit te Drinit ne Klasen III – (Gjendje e moderuar) ku stacionet D1, D2, D3, Bu1 jane te nje cilesie shume te mire por stacionet Bu2 – Ura e Vjeter Shkoder dhe DLe – Para derdhjes ne det ku paraqesin vlera <7 mg/l dhe >3.5 mg/l te nevojës biokimike per oksigjen duke i -Basenit te Matit klasifikohen ne Klasen III – (Gjendje e moderuar) per shkak te vleres mesatare te Nevojës Biokimike per Oksigjen ne stacionin Ma2 – Fani I Vogel. -Baseni Ishem – Erzen klasifikohet ne Klasen V.

– (Gjendje e keqe).

- Basenit te Shkumbinit klasifikohen ne Klasen e IV – (Gjendje e varfer per shkak te dy stacioneve te cilat paraqesin ndotje si Ura e Paprit dhe Ura Rrogozhine te cilat paraqesin vlera te larta te Nevojës Biokimike per Oksigjen.)- Basenit te Vjoses klasifikohen si ujera me cilesi te mire te cilat renditen ne Klasen II – (Gjendje e mire).

- Baseni i Semanit klasifikohet ne Klasen Vgjendje e keqe me stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier si stacionin me te ndotur ku impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale eshte shume i madh.
- Liqenit te Prespes jane te cilesise mezotrofike ndersa Liqeni i Prespes se vogel klasifikohet si liqen me cilesi eutrofike.
- Liqenit te Ohrit kane tendence per te shkuar drejt mezotrofise
- Liqenit te Shkodres jane te cilesise mezotrofike

Duke vleresuar te dhenat e marra nga ekspeditat e kryera eshte vleresuar se ne rrjedhen e siperme ujerat jane te nje cilesie shume te mire por duke zbritur afer zonave urbane vihet re nje impakt shume i larte i shkarkimeve qe shkojne direkt ne lume pa asnje lloj trajtimi paraprak si pasoje e shkarkimeve urbane, industriale e bujqesore duke ndikuar ne cilesine e ujrave siperfaqesore.

Lumenjte me te ndotur ne Shqiperi jane Lumi i Tiranes me stacionet e monitorimit me te ndotura Yrshek – Ish Dogana, Ura Rinas, Ura e Gjoles dhe Ura Salmer, Lumi i Shkumbinit me stacionin e monitorimit me te ndotur Ura e Rrogozhines, Lumi Gjanica dhe Lumi Seman.

Ky vleresim i situates se lumenjve kryesore te Shqiperise ka impaktin e vet ne cilesine e ujrave nentokesore, ne cilesine e deteve dhe ne ekosistemet ujore dhe permiresimi i tyre lidhet me

1. Mos shfrytezimi pa kriter i inerteve ne zona te caktuara
2. Menjanimi i shkarkimeve urbane
3. Ndertimi i impianteve te trajtimit te ujrave te zeza
4. Ndergjegjesimi i qytetareve per mos-perdorimin e lumenjve si vend-depozitime.



Paraqitje skematike e shkaqeve të eutrofikimit

Vlerësimi i cilësisë së ujrave bregdetarë të larjes në Shqipëri edhe gjatë vitit 2018 është kryer në 108 stacione monitorimi në plazhet kryesore të bregdetit si: Velipojë, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjirit të Lalzit, Kavajës (Golemi, Spille, Qerret) Divjakes, Semanit, Vlorës (Vlore, Orikum, Zvërnec), Palasës, Dhërmiut, Himarës, Borshit, Qeparoit, Sarandës, Ksamilit, Lin Pogradë.

Cilesia e lumenjeve (*Bazuar ne studimin kombetare vjetor qe behet nga agjencia kombetare e mjedisit*)

Monitorimi i cilesise se ujit eshte i rëndesishem per mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujrave, identifikimin e shkaktareve te ndotjes deri ne dhenien e rekomandimeve perkatese sipas problematikave te identifikuar. Ky program monitorimi me nje frekuence 4 here/vit siguron nje baze te dhenash, te cilat perdoren ne nivel lokal, kombetare e nderkombetare si dhe raportimet ne Agjencine Europiane te Mjedisit.


PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

IV. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS

Pershkrimi i projektit

Projekti per “MAGAZINIM I HEKURISHTEVE/SKRAPEVE TË METALIT QË NUK PËRMBAJNË MATERIALE TË RREZIKSHM OSE ÇMONTIM I MBETJEVE NGA MOTORËT E MAKINAVE”, me vendndodhje në Dobresh, Njesia Administrative Berzhite, Bashkia Tirane. Ky investim do te kryhet ne prone shoqerise “SBFD FRIGO 09” Shpk, në pasurinë me 426/81, zona kadastrale nr.1498.

Subjekti “SBFD FRIGO 09” Shpk regjistruar si person juridik ne QKB (Qendra Kombetare e Bizneseve) me numer unik identifikimi te subjektit NUIS L31318014Q, me adresë Tirane, Berzhite, Dobresh, Njesia Administrative Berzhite, Zona Kadastrale Nr.1498, me nr. pasurie 426/80, Bashkia Tirane. Ky subjekt kryen aktivitet ne fushen e montim, zbatim dhe mirembajtje sistemesh e pajisjesh ftohese, ngrohese, aspiruese, dhoma frigoriferike, ftohese etj.



Plavendosja e objektit ku parashikohet te ndertohet, pozicioni kadastral

Proceset qe do behen ne objekt

E gjithë veprimtaria e subjektit është “Magazinim dhe tregtim Skrapi”. duke grumbulluar kryesisht materialet prej hekuri qe i bien qytetare te ndryshem kundrejt peshes se tyre dhe qe marrin pagesen.

Ne kete aktivitet nuk ka mbetje dhe nuk krijohen mbeturina, sepse i tille eshte aktiviteti. Ne kete subjekt jane punesuar punonjes te cilat jane specializuar ne fushat perkatese te ketij aktiviteti duke kryer detyrat si shofer, manovrator i makinerise ngarkuese, etj.

Mbetjet urbane

Impakte te gjeteshme

Vendi yne nga viti ne vit po rrit interesin per permiresimin e sistemit te mbledhjes dhe menaxhimit te mbetjeve urbane. Si impakt i gjetshem ne kete zone do te cilesojme mungesen e sistemit te seleksionimit te mbetjeve qe ne origjine, vendosjen e kontenjerve te pershtatshem per kete. Duhet te theksojme se kjo i perket inisjativave te qeverisjes qendore, sigurisht qe plani vendore mer persiper propozimin per permiresimin e sistemit te menaxhimit te mbetjeve.

Referuar VKM Nr.99, date 18.02.2005 Per miratimin e katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve", mbetjet qe prodhohen klasifikohen me kodet:

20 01 01 Leter dhe karton

20 01 02 Qelq

20 01 39 Plastiket

20 01 40 Metalet

20 02 02 Dhera dhe gure

Depozitim i mbetjeve do të bëhet ne perputhje me “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” i ndryshuar dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” si dhe VKM nr.371, datë 11.06.2014“Për percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme”.

Masat per permiresimin e sitemit te menaxhimit te mbetjeve

Ne Njesine Administrative Berzhite qe ndodhet objekti qe eshte parashikuar per tu ndertuar problemi i mbetjeve nuk haset si problematike e rende pasi nje pjese dominuese e komunitet kane informacion te larte per mbajtjen paster te mjedisit ku jetojne, por lind deshira dhe nevoja qe kjo Njesi vendore te permiresoje akoma me tej kete sistem ne bashkepunim me organet perkatese.

- Vendosja e pikave ku do te vendosen kontenjeret e grumbullimit te mbetjeve sidomos gjate periudhes se Veres.
